

AUTORIZIM

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 26.7.2018, “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, i ndryshuar,

AUTORIZOJ:

1. Z. Ajet Zyberaj, me detyrë Drejtues i Task-Forcës “Për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, të kryejë detyrat sa më poshtë:
 - a) detajimin e shpenzimeve të Task-Forcës;
 - b) emërimin e punonjësve të Task- Forcës;
 - c) nënshkrimin e kontratave të punës me punonjësit e emëruar pranë kësaj strukture.
2. Ky autorizim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku